AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat Afatshkurtra të Industrisë, Shtator 2023

12.12.2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat Afatshkurtra të Industrisë për muajin shtator 2023.

Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave më i ulët në shtator 2023, krahasuar me shtator 2022

Në muajin shtator të vitit 2023, indeksi i vëllimit të prodhimit në sektorët e industrisë kishte rritje në sektorin e industrisë përpunuese (11,1%), krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (Shtator 2022).

Ndërsa, rënie kishte te: furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (-26,0%); industria nxjerrëse (minierat dhe guroret) (-14,2%); furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (-12,0%).

Aktivitetet ekonomike sipas NACE Rev-2



Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial për periudhën Shtator 2023 – Shtator 2022

Sektorët	09-2022	09-2023	09-2022 / 09-2023
Industria nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	121,3	104,1	-14,2%
Industria përpunuese	144,3	160,3	11,1%
Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	145,7	108,1	-26,0%
Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	121,1	107,0	-12,0%

Indeksi i numrit të të punësuarve

Në muajin Shtator 2023, indeksi i numrit të të punësuarve ishte në sektorin e industrisë përpunuese ishte 0,3%; Sektori i furnizimit me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (-3,0%); Minierat dhe guroret (-7,0%); Furnizimit me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (-8,2%); krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (Shtator 2022).

Ndryshimi i indeksit të numrit të të punësuarve për periudhën Shtator 2023 – Shtator 2022

Sektorët	09-2022	09-2023	09-2022 / 09-2023
Industria nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	98,1	91,6	-7,0%
Industria përpunuese	107,9	108,2	0,3%
Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	91,6	89,0	-3,0%
Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	105,1	96,5	-8,2%

Për më shumë informata lidhur me Statistikat Afatshkurtra të Industrisë për muajin shtator 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/ShortStats

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS